

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Kontabilitet-Financës, zhvilloi një vizitë studimore në punishten e gdhendjes së drurit.

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja e studentëve me proceset praktike të funksionimit të një biznesi prodhues, organizimin e punës, menaxhimin financiar dhe aspektet ekonomike që lidhen me këtë aktivitet.

Studentët u njohën me procesin e përpunimit të drurit, mënyrën e funksionimit të biznesit dhe fituan njohuri praktike mbi menaxhimin dhe administrimin financiar.

Ky aktivitet synoi të afrojë studentët me tregun e punës dhe t'i ndihmojë ata të krijojnë një lidhje më të qartë ndërmjet njohurive teorike dhe praktikës profesionale.

Në aktivitet morën pjesë studentë të ciklit Bachelor dhe programeve 2-vjeçare me karakter profesional, si Ndihmës Ekonomist, Asistent Administrativ dhe Asistent Menaxher në Shërbimet Turistike.

